



Udhëzim 8

Shtator 2016

Prokurimi publik

Vendosja e kriterëve të dhënies së kontratës

PËRMBAJTJA

- [Konteksti i përgjithshëm](#)
- [Zbatimi i kriterit të vetëm të çmimit](#)
- [Metodat që përdoren për të identifikuar raportin më të mirë çmim/cilësi](#)
- [Strategjia e përgjithshme për zbatimin e kriterëve të dhënies së kontratës: lista e kontrollit](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Ky udhëzim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Ai nuk duhet të citohet si përfaqësim i pikëpamjeve zyrtare të BE-së, OECD-së ose vendeve anëtare të saj, apo të përfituesve që marrin pjesë në Programin SIGMA. Mendimet e shprehura dhe argumentet e përdora janë vetëm të autorit (ve).

Ky dokument dhe ndonjë hartë e përfshirë në të nuk e paragjykojnë statusin apo sovranitetin e ndonjë territori, demarkacionin e kufijve ndërkombëtarë apo administrativë, si dhe emrin e ndonjë territori, qyteti apo rajoni.

Konteksti i përgjithshëm

Kriteret e dhënies së kontratës përbëjnë bazën mbi të cilën autoriteti kontraktor zgjedh ofertën më të mirë dhe shpall fituesin. Këto kriteret duhet të përcaktohen paraprakisht nga autoriteti kontraktor dhe nuk duhet të jenë të dëmshme për konkurrencën e ndershme.

Direktiva e Sektorit Publik 2004¹ i lejon autoritetet kontraktore që të japin një kontratë publike bazuar në sa më poshtë vijon:

- Kriteri i çmimit më të ulët; ose
- Kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme, që do të thotë zbatimi i kriteret të tjera përveç çmimit, ose i kriterëve të ndryshme nga çmimi.

Zgjedhja në mes të këtyre dy opsioneve është lënë në diskrecionin e autoriteteve kontraktore. Vetëm në raste shumë të kufizuara, të tilla siç është përdorimi i varianteve dhe zbatimi i procedurave të dialogut konkurrues, Direktiva 2004 kërkon kriterin ekonomikisht më të favorshëm.

Direktiva e Sektorit Publik 2014 (Direktiva)² ka ndryshuar këtë qasje duke e vënë një theks shumë më të madh në vlerësimin e ofertave në bazë të kriterëve të tjera përveç kriterit thjesht vetëm të çmimit. Prandaj, Direktiva kërkon nga autoritetet kontraktore që të bazojnë dhënien e kontratës në ofertën ekonomikisht më të favorshme. Pavarësisht nga faktorët që merren parasysh, kontrata duhet t'i jepet ofertuesit që paraqet ofertën ekonomikisht më të favorshme. Sigurisht që zbatimi i kriterit vetëm të çmimit lejohet ende, edhe pse Shtetet Anëtare mund ta kufizojnë zbatimin e tij.

Koncepti i ofertës ekonomikisht më të favorshme shpjegohet pasi oferta që është ekonomikisht më e favorshme nga pikëpamja e autoritetit kontraktor. Ajo identifikohet në bazë të çmimit ose koston (duke përdorur qasjen e kosto-efektivitetit, të tillë si kostoja e ciklit të jetës) ose raportin më të mirë çmim/cilësi. Në rastin e fundit, raporti vlerësohet në bazë të kriterëve të lidhura me subjektin e prokurimit publik, duke përfshirë edhe aspektet cilësore, mjedisore dhe/ose sociale. Raporti më i mirë çmim/cilësi në Direktivë është ekuivalenti i ofertës ekonomikisht më të favorshme në Direktivën 2004.

Për ta përmbledhur, oferta ekonomikisht më e favorshme tani është kriteri i vetëm për dhënien e kontratave. Zbatimi i këtij kriteri mund të përfshijë tri qasje të ndryshme:

- Vetëm çmimin;
- Vetëm koston - duke përdorur qasjen e kosto-efektivitetit, të tillë si kostoja e ciklit të jetës;
- Raportin më të mirë çmim/cilësi.

Pavarësisht se cila metodë përdoret, në vlerësimin e ofertave duhet të përfshihet gjithmonë një element ekonomik.

Elementi i koston mund të marrë formën e një çmimi fiks ose të koston në bazë të së cilit operatorët ekonomik do të konkurrojnë vetëm mbi kriteret e cilësisë.

Zgjedhja në mes të tri metodave të lartpërmendura në përgjithësi është lënë në gjykimin e autoritetit kontraktor, përveç rasteve të dialogut konkurrues dhe partneritetit të inovacionit, ku duhet të përdoret kriteri i raportit më të mirë çmim/cilësi. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë gjithashtu që autoritetet kontraktore mund të mos përdorin vetëm çmimin ose vetëm koston si kriter të vetëm për dhënien e kontratës, ose mund të kufizojnë aplikimin e tyre për kategori të caktuara të autoriteteve kontraktore ose lloje të caktuara të kontratave.

¹ Direktiva 2004/18/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, 31 mars 2004.

² Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike, që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

Për procedurat e prokurimit që kërkojnë njoftim të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të shpallë në njoftimin e kontratës nëse ai do të aplikojë metodën e vetëm çmimit, vetëm koston apo të raportit më të mirë çmim/cilësi. Në rastin e metodës së raportit më të mirë çmim/cilësi, kriteret që do të përdoren duhet të shpallen ose në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e prokurimit. Direktiva përcakton rregullat e përgjithshme në lidhje me formulimin e kriterëve të veçanta që mund të zbatohen kur përdoret metoda e raportit çmim/cilësi, ndërkohë që ajo përcakton gjithashtu edhe detyrimet për dhënien e informacionit në lidhje me kriteret për të zgjedhur ofertën që siguron raportin më të mirë çmim/cilësi. Objektivi kryesor i ligjvënësit të Bashkimit Evropian (BE) është të garantojë që tregtia brenda BE-së të mos kufizohet nga kriteret diskriminuese të dhënies së kontratës.

Kur vendosen kriteret e dhënies së kontratës, autoriteti kontraktor duhet të veprojë në lidhje me parimet e përgjithshme të së drejtës dhe të Traktatit³ dhe, në mënyrë të veçantë, të sigurojë sa më poshtë:

- **Trajtimin e barabartë dhe mos-diskriminimin**, që do të thotë se kriteret e dhënies duhet të jenë jo diskriminuese dhe nuk duhet të jenë të dëmshme për konkurrencën e ndershme;
- **Transparencën**, që do të thotë se kriteret e dhënies duhet të vendosen paraprakisht dhe t'i bëhen të ditura ofertuesve sipas rregullave. Qëllimi i krijimit dhe i publikimit në mënyrë zyrtare i kriterëve të dhënies së kontratës që do të zbatohen është që të garantojë që:
 - Ofertuesit mund të përgatisin ofertat e tyre në një mënyrë më të përshtatshme, duke u përpjekur për të përmbushur më mirë prioritetet e deklaruara të autoritetit kontraktor;
 - Vlerësimi i ofertave kryhet nga autoriteti kontraktor në mënyrë transparente dhe të besueshme dhe sa më objektive;
 - Palët përkatëse të interesuara, siç janë organet e kontrollit, organet e shqyrtimit, organet e tjera qeveritare ose operatorët ekonomik, mund të monitorojnë procesin për të parandaluar përdorimin e kriterëve diskriminuese ose të paautorizuara të dhënies së kontratës.

Zbatimi i kriterit të vetëm të çmimit

Kur një autoritet kontraktor zgjedh të zbatojë kriterin ekonomikisht më i favorshëm në bazë të vetëm çmimit, kontrata i jepet tenderuesit që ofron çmimin më të ulët për një ofertë në përputhje me rregullat. Çmimi është faktori i vetëm që merret në konsideratë kur zgjedh ofertën më të mirë në përputhje me rregullat. Ofertat e pranuar vlerësohen kundrejt specifikimeve të caktuara mbi bazën e rregullit nëse e kalon ose nuk e kalon sistemin. Në këtë zgjedhje nuk mund të hyjë në lojë as analiza e koston dhe as vlerësimet e cilësisë.

Kufizimet e kriterit të vetëm të çmimit: kriteri i vetëm i çmimit ka avantazhin e thjeshtësisë dhe të shpejtësisë, por ai paraqet disa kufizime, duke përfshirë sa më poshtë:

- Ai nuk e lejon autoritetin kontraktor që të marrë parasysh vlerësimet cilësore. Përveç faktorëve të cilësisë të përfshirë tek specifikimet, të cilat duhet të plotësohen nga të gjitha ofertat, cilësia e kërkesës që prokurohen nuk është subjekt i vlerësimit.
- Ai nuk e lejon autoritetin kontraktor që të marrë në konsideratë inovacionin dhe zgjidhjet e reja. Ofertat që plotësojnë specifikimet e përcaktuara janë në përputhje me rregullat.

³ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati"

- Për kërkesat që kanë një jetë të gjatë operative, ai nuk e lejon autoritetin kontraktor që të marrë parasysh kostot e ciklit të jetës së kërkesës së prokuruar. Kur përdoret kriteri i çmimit më të ulët, atëherë mund të merret parasysh vetëm kosto direkte e blerjes ose çmimi fillestar i blerjes brenda specifikimeve të caktuara.

Metoda që përdoren për të identifikuar raportin më të mirë çmim/cilësi

Kur përdoret oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në raportin më të mirë të çmim/cilësi, autoriteti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e tjera, përveç - ose të ndryshme nga - çmimi, të tilla si cilësia, koha e ofrimit, dhe shërbimet pas shitjes. Çdo kriteri të zgjedhur i jepet një peshë relative nga autoriteti kontraktor, i cili reflekton rëndësinë relative që ka. Qëllimi i raportit më të mirë çmim/cilësi është që të identifikojë ofertën që ofron vlerën më të mirë të parasë.

Vlera e parasë: Termi vlera e parasë nënkupton kombinimin optimal në mes të kriterëve të ndryshme të lidhura me koston dhe jo të lidhura me koston që, së bashku, përbushin kërkesat e autoritetit kontraktor. Megjithatë, elementet që përbëjnë kombinimin optimal të këtyre kriterëve të ndryshme ndryshojnë nga një prokurim në një prokurim tjetër dhe varen nga rezultatet e kërkuara nga autoriteti kontraktor për ushtrimin e prokurimit në fjalë.

Koncepti i vlerës së parasë pranon se mallrat, punët dhe shërbimet nuk janë homogjene dhe se ato ndryshojnë në cilësi, qëndrueshmëri, jetëgjatësi, disponueshmëri dhe kushtet e tjera të shitjes. Qëllimi i kërkimit të vlerës së parasë është që autoritetet kontraktore duhet të synojnë që të blejnë kombinimin optimal të karakteristikave që plotësojnë nevojat e tyre. Prandaj cilësitë e ndryshme, të tilla si kostot e brendshme, jetëgjatësia dhe qëndrueshmëria që produktet e ndryshme ofrojnë maten kundrejt koston të tyre. Mund të jetë e preferueshme që të paguhet më shumë për një produkt që ka kosto të ulët të mirëmbajtjes sesa të paguhet më pak për një produkt më të lirë që ka kosto më të lartë të mirëmbajtjes.

Avantazhet e raportit më të mirë çmim/cilësi: Raporti më i mirë çmim/cilësi, ndryshe nga kriteri i vetëm i çmimit, paraqet një sërë avantazhesh, duke përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa më poshtë:

- Lejon autoritetet kontraktore të marrin parasysh vlerësimet cilësore. Raporti më i mirë çmim/cilësi përdoret zakonisht kur cilësia është e rëndësishme për autoritetin kontraktor.
- Lejon autoritetet kontraktore të marrin parasysh inovacionet apo zgjidhjet e reja. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat janë burim i inovacionit dhe i aktiviteteve të rëndësishme të kërkimit dhe zhvillimit.
- Për kërkesat me një jetë të gjatë operative, i mundëson autoritetit kontraktor që të marrë parasysh kostot e ciklit të jetës të kërkesës së blerë dhe jo vetëm koston e drejtpërdrejtë të blerjes ose çmimin fillestar të blerjes brenda specifikimeve të caktuara.

Cilat kriterë mund të përdoret për të përcaktuar raportin më të mirë çmim/cilësi?

Autoriteti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e ndryshme për të përcaktuar raportin më të mirë çmim/cilësi.

Direktiva përmban një listë ilustruese e këtyre kriterëve, të cilat janë si më poshtë:

- Cilësia, përfshirë edhe meritat teknike;
- Karakteristikat estetike dhe funksionale;
- Aksesueshmëria;
- Projektimi për të gjithë përdoruesit;
- Karakteristikat sociale, mjedisore dhe inovative;
- Tregtimi dhe kushtet e tij;

- Organizimi, kualifikimi dhe përvoja e personelit të caktuar për të realizuar kontratën, ku cilësia e personelit të caktuar mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në nivelin e zbatimit të kontratës;
- Shërbimet pas shitjes dhe asistencë teknike;
- Kushtet e dorëzimit, të tilla si data e dorëzimit, procesi i dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose koha e përfundimit.

Meqë lista është vetëm ilustruese, i është lënë në dorë autoritetit kontraktor që të vendosë kriteret që do të zbatohen për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme nga këndvështrimi i tij, duke marrë parasysh rrethanat specifike të secilit rast dhe brenda kufizimeve të caktuara të specifikuara.

Kriteret e dhënies së kontratës mund të ndahen në dy kategori të gjera: Kriteret **e lidhura me koston** dhe kriteret **që nuk lidhen me koston**.

Kriteret e lidhura me koston: Kriteret e lidhura me koston, të cilat janë njihen edhe si kriteret ekonomike, i mundësojnë autoriteti kontraktor që të përcaktojë koston financiare të blerjes së objektit të prokurimit, si dhe koston e përdorimit dhe të operimit të tij.

Kostot e ciklit të jetës

Kostot e ciklit të jetës janë kostot e mallrave, punëve ose shërbimeve gjatë kohëzgjatjes së ciklit të tyre jetësor. Në vija të përgjithshme, kostot e ciklit të jetës përfshijnë të gjitha shpenzimet e autoritetit kontraktor në lidhje me:

- Blerjen;
- Jetën operacionale;
- Fundin e jetës (siç është depozitimi).

Kostot e ciklit të jetës mund të jenë “kostot që paguhen njëherë” ose “kostot periodike”. Kostot që paguhen vetëm një herë janë ato që paguhen me blerjen e kërkesës që prokurohet, të tilla si çmimi fillestar, kostot e blerjes dhe të instalimit, kostot e trajnimit fillestar apo të depozitimit. Kostot periodike janë ato që paguhen në të gjithë ciklin e jetës së kërkesës që prokurohet. Ato varen nga jetëgjatësia e saj dhe normalisht rriten me kalimin e kohës. Kostot periodike përfshijnë tarifatat e shërbimit dhe mirëmbajtjes, riparimet, materialet e konsumueshme, pjesët e këmbimit dhe konsumin e energjisë.

Për më shumë informacion, shikoni Udhëzimin nr. 34 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Kostoja e Ciklit të Jetës*.

Kriteret që nuk lidhen me koston: Kriteret që nuk lidhen me koston kanë të bëjnë me kërkesat kyçe të performancës dhe zbatimin e specifikimeve. Shembuj të kriterëve që nuk lidhen me koston përfshijnë sa më poshtë vijon:

- **Karakteristikat e cilësisë** – karakteristikat e cilësisë që objekti i prokurimit duhet të plotësojë, të tilla si numri i faqeve për minutë të prodhuara nga një printer apo qëndrueshmëria e tij;
- **Merita teknike** - nëse objekti i prokurimit është i përshtatshëm për qëllimin e tij dhe sa mirë funksionon ai;
- **Karakteristikat estetike dhe funksionale** – si duket dhe ndjehet objekti i prokurimit dhe sa e lehtë është për t'u përdorur atë;
- **Data e dorëzimit** - koha e garantuar nga momenti i porositjes deri në momentin e dorëzimit dhe aftësia për të përmbushur afatin e caktuar;

- **Shërbimet pas shitjes** - mbështetja që është e nevojshme dhe në dispozicion të autoritetit kontraktor pasi kontrata të jetë nënshkruar.

Nën-kriteret: Autoriteti kontraktor mund të vendosë edhe nënndajë në nën-kritere ato kritere që janë zgjedhur për të përcaktuar raportin më të mirë çmim/cilësi. Nën-kriteret tregojnë faktorët specifik që janë marrë në konsideratë nga autoriteti kontraktor brenda një kriteri të caktuar.

A kufizohet diskrecioni i autoritetit kontraktor kur vendosen kriteret që do të zbatohen për të përcaktuar raportin më të mirë çmim/cilësi?

Direktiva i referohet ofertës që është ekonomikisht më e favorshme "nga pikëpamja e autoritetit kontraktor", duke vënë theksin në diskrecionin e autoritetit kontraktor për zgjedhjen e kritereve që do të aplikohen. Megjithatë, ky diskrecion nuk është i pakufizuar dhe ka disa kufizime, si më poshtë:

- Kriteret e zgjedhura duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës publike në fjalë.
- Kriteret e zgjedhura duhet të synojnë identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme dhe ato nuk mund të synojnë qëllime të tjera.
- Kriteret e zgjedhura duhet të jenë objektive dhe objektivist të matshme nga ana sasiore.

Për të garantuar objektivitetin e kritereve që do të zbatohen dhe për të parandaluar dhënien autoritetit kontraktor të diskrecionit të pakufizuar të zgjedhjes, këto kritere duhet të formulohen në mënyrë të saktë dhe në mënyrë të matshme sa më shumë që të jetë e mundur. Ofertuesit duhet të jenë në gjendje të përgatisin ofertat e tyre duke marrë parasysh mënyrën në të cilën do të bëhet llogaritja/vlerësimi i ofertave.

Raporti më i mirë çmim/cilësi dhe specifikimet e kontratës: disa vlerësime të rëndësishme

Në praktikë, kriteret që autoriteti kontraktor mund të aplikojë për të përcaktuar raportin më të mirë çmim/cilësi duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që ato të përputhen me specifikimet e kontratës. Të gjitha specifikimet që janë subjekt i vlerësimit duhet të kenë kritere të lidhur me to.

Përgatitja e specifikimeve dhe përcaktimi i kritereve që do të zbatohen për të përcaktuar raportin më të mirë çmim/cilësi shkojnë së bashku. Specifikimet e kontratës nuk mund të përgatiten pa marrë parasysh kriteret që do të zbatohen, dhe, anasjelltas, kriteret që do të zbatohen nuk mund të përcaktohen pa marrë parasysh specifikimet e kontratës.

Kur përdoret raporti më i mirë çmim/cilësi, në përgjithësi autoriteti kontraktor mund të vendosë që të veprojë në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Autoriteti kontraktor mund të vendosë që të përcaktojë specifikimet minimale të detyrueshme që të gjitha ofertat duhet të plotësojnë dhe ofertat do të vlerësohen në bazë të sistemit kalon ose nuk kalon, dhe pastaj ofertave që kanë arritur të kalojnë u jepen pikë. Pikët do të pasqyrojnë shkallën në të cilën oferta tejkalon specifikimet minimale.
- Autoriteti kontraktor mund të vendosë që të përcaktojë, përveç specifikimeve të detyrueshme ose si një alternativë ndaj tyre, specifikimet që nuk përfshijnë zbatimin e "pragut" minimal dhe ofertat do të vlerësohen në bazë të nivelit të pajtueshmërisë së tyre me kërkesat e autoritetit kontraktor. Në këtë rast, pranohet njëfarë ndryshueshmërie në lidhje me nivelin e pajtueshmërisë.

Cilat metoda mund të përdoren për të identifikuar ofertën ekonomikisht më të favorshme?

Metodat apo metodologjitë e zbatimit të kritereve të zgjedhura janë "sistemet" që autoriteti kontraktor mund të përdorë për të identifikuar ofertën ekonomikisht më të favorshme.

- **Ponderimi:** Direktiva kërkon që autoriteti kontraktor të përcaktojë peshën relative që ai i jep secilit kriter të zgjedhur në mënyrë që të përcaktohet oferta ekonomikisht më e favorshme.

Nëpërmjet sistemit të ponderimit, autoriteti kontraktor njofton ofertuesit për rëndësinë relative që ai i jep secilit kriter të zgjedhur dhe u mundëson ofertuesve që të përgatisin oferta më të përshtatshme. Në të njëjtën kohë, përmes sistemit të ponderimit, autoriteti kontraktor kufizon mundësitë për vendime arbitrare gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor mund të shprehë peshën relative të kriterëve të përdorura, duke parashikuar një gamë me një objekt maksimal "të përshtatshëm". Qëllimi duhet të jetë i përshtatshëm në kuptimin që nuk mund të jetë aq i gjerë (për shembull, në mes të 10% dhe 90%), që do të rezultonte në një shkelje të parimit të transparencës dhe se nuk do t'i jepte ndonjë tregues të vlefshëm ofertuesve të mundshëm lidhur me rëndësinë faktike relative që autoriteti kontraktor i jep secilit kriter të përdorur.

Ponderimi i kriterëve të ndryshme që do të zbatohen për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme duhet të kryhet me kujdesin e duhur. Ponderimi i papërshtatshëm do të shkaktonte probleme gjatë kryerjes së vlerësimit të ofertave dhe mund të nënkuptojë që nuk do të zgjidhet oferta që ofron vlerën më të mirë të parasë.

- **Rendi zbritës i rëndësisë:** Kur ponderimi nuk është i mundur për arsye të vërtetueshme, autoriteti kontraktor duhet të tregojë kriteret e zbatuara në rend zbritës të rëndësisë. Një nga arsyet që ponderimi mund të mos jetë i mundur është kompleksiteti i kontratës.

Detyrimet për dhënie informacionesh shpjeguese në lidhje me kriteret që do të zbatohen për të përcaktuar raportin më të mirë çmim/cilësi **dhe në lidhje me metodat për aplikimin e tyre:** Autoriteti kontraktor duhet të njoftojë në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e kontratës, ose, në rast të një dialogu konkurrues, në dokumentin përshkrues:

- Kriteret që përfaqësojnë ofertën ekonomikisht më të favorshme,
- Ponderimin e tyre relativ apo rendin zbritës të rëndësisë së kriterëve të tilla (ku, sipas mendimit të autoritetit kontraktor, ponderimi nuk është i mundur).

Me përjashtim të këtyre detyrimeve të qarta për dhënie informacionesh shpjeguese të përmendura më lart, Direktiva nuk kërkon në mënyrë specifike që autoriteti kontraktor të formulojë paraprakisht një metodologji të detajuar të vlerësimit. Megjithatë, kur një autoritet kontraktor ka formuluar një metodologji të detajuar vlerësimi që më parë, kjo metodologji duhet t'u bëhet e ditur plotësisht ofertuesve.

Dokumentet e tenderit duhet të tregojë sa më shumë transparencë që të jetë e mundur duke ofruar informacion të qartë se si do të zhvillohet procesi i vlerësimit dhe për të gjithë faktorët që do të merren parasysh (duke përfshirë edhe peshën e tyre relative), si dhe metodologjitë që do të zbatohen për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Ky informacion jo vetëm që do të ndihmojë ofertuesit potencialë në përgatitjen e ofertave më të përgjegjshme, por ai do të bëjë gjithashtu të gjithë procesin e tenderit, duke përfshirë procesin e vlerësimit, më transparent. Ai gjithashtu do t'u mundësojë palëve të interesuara përkatëse (në veçanti ofertuesit, organet e auditimit dhe organet e tjera qeveritare) që të monitorojnë procesin e tenderit në mënyrë që të identifikohen situatat ku kriteret ose metodologjitë e vlerësimit janë zhvilluar dhe/ose zbatuar në mënyrë diskriminuese.

Paralajmërim - ndryshimi i kriterëve të publikuara të dhënies së kontratës gjatë procesit të tenderit: Në asnjë rrethanë nuk mund të ndryshohen ose të hiqen gjatë procesit të vlerësimit të ofertave kriteret e publikuara të dhënies së kontratës (duke përfshirë ponderimin e tyre relativ dhe nën-kriteret e zbatuara, dhe metodologjinë më të detajuar të vlerësimit që është shpallur). Në këtë fazë, ato duhet të zbatohen ashtu siç janë.

Strategjia e përgjithshme për zbatimin e kriterëve të dhënies së kontratës

Strategjia e përgjithshme në lidhje me kriteret e dhënies së kontratës që do të zbatohen duhet të përcaktohet para se të nisë një tender. Listë e kontrollit më poshtë paraqet disa nga pikat kryesore që autoriteti kontraktor mund të zgjedhë për të trajtuar, kur ai përcakton strategjinë e tij të përgjithshme:

- 1) Marrja e vendimit se cilat kriteret e dhënies së kontratës të zbatohen: kriterin e vetëm të çmimit, kriterin e vetëm të kostos apo kriterin e raportit më të mirë çmim/cilësi, kur ka një zgjedhje.
- 2) Identifikimi se sa herë është zgjedhur kriteri i raportit më të mirë çmim/cilësi:
 - a) Kriteret individuale që do të zbatohen dhe pesha e tyre relative (ose rendi i tyre zbritës i rëndësisë në rastin kur ponderimi nuk mund të zbatohet për arsye të dukshme);
 - b) Nën-kriteret dhe pesha e tyre relative brenda peshës së dhënë për këtë kriter individual, ku është vendosur që çdo kriter të ndahet në nën-kritere;
 - c) Metodologjia më e detajuar e vlerësimit, kur është vendosur aplikimi i saj, dhe përcaktimi i saj në një mënyrë të qartë.
- 3) Identifikimi, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi, se ku dhe si duhet të bëhen të ditura elementet e mëposhtme:
 - d) Përdorimi i kriterit të vetëm të çmimit, kriterit të vetëm të kostos ose i kriterit të raportit më të mirë të çmim/cilësi, sipas rastit;
 - e) Sa herë është zgjedhur raporti më i mirë çmim/cilësi:
 - (i) kriteret individuale që do të zbatohen dhe pesha e tyre relative (ose rendin i tyre zbritës i rëndësisë nëse ponderimi nuk mund të zbatohet për arsye të dukshme);
 - (ii) Çdo nën-kriter, në të cilën çdo kriter që do të aplikohet është ndarë dhe pesha e tyre relative brenda peshës që i është dhënë këtij kriteri individual;
 - (iii) Çdo metodologji vlerësimi që është zhvilluar.

Shërbimet

Direktiva 2014 e Shërbimeve (Direktiva e Shërbimeve)⁴ përdor të njëjtën metodë si Direktiva e Sektorit Publik dhe kërkon që subjektet kontraktore të bazojnë dhënien e kontratës në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Përkufizimi i ofertës ekonomikisht më të favorshme, në bazë të nenit 82 të Direktivës së Shërbimeve, është në thelb e njëjtë si në Direktivë, përveç një dispozite shtesë që përfshin tek shembujt e kriterëve të lejuara një referencë për "angazhimet në lidhje me pjesët e sigurimi i furnizimit "[neni 82(2)(c)].

⁴ Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

Informacion i mëtejshëm

Botimet e SIGMA-s

Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli E4

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e Prokurimit Publik të SIGMA-s

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

Udhëzimi i Prokurimit Publik 9, *Vlerësimi i Ofertave dhe Dhënia e Kontratës*

Udhëzimi i Prokurimit Publik 34, *Kostoja e ciklit të jetës*

SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik (2006-2014)*, Botimet e OECD-së, Paris.

<http://www.sigmaweb.org/publications/Judgements-CourtJustice-31July2014-Alb.pdf>

Jurisprudenca

Jurisprudencë e zgjedhur e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian: 31/87 *Beentjes*, C-513/99 *Concordia Bus Finland*, C-19/00 *SIAC Construction*, C-315/01 *GAT*, C-448/01 *EVN AG dhe Wienstrom GmbH kundër Republikës së Austrisë*, C-532/06 *Lianakis dhe të tjerët* C-46/15 *Ambisig*

http://curia.europa.eu/jcms/jcms/j_6/